



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 270 akti

Nr. 145 Vendimi
Tiranë, më 08.05.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, sot më datë 08.05. 2019, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

Subjektit të rivlerësimit: Z. Apostol Prifti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Baza ligjore: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.04.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me vendimin nr. ***, datë 25.04.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit” për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension, të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, z. Apostol Prifti. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension, më datë 30.04.2019, të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, z. Apostol Prifti.
2. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në fletoren zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi më datë 08.10.2016.
3. Më datë 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye afati i zbatimit të ligjit u shty për 17 ditë, deri në 19 janar 2017. Më datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në fletoren zyrtare, më datë 19.01.2017. Si rezultat afati 30 ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë ka përfunduar në datën 31 janar 2017.
4. Procesi i rivlerësimit për z. Apostol Prifti, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka filluar menjëherë me:
 - a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
5. Më datë 15.01.2019, u hodh shorti pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për trupin gjykues, i cili do të shqyrtojë dhe do të vendosë mbi procesin e rivlerësimit të subjektit Apostol Prifti.
6. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Suela Zhegu	Relatore

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

7. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
8. Pika 3, e nenit 179/b, i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.
9. Me vendimin nr. ***, datë 25.04.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të plotësimit së moshës për daljen në pension, më datë 30.04.2019, të z. Apostol Prifti, prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
10. Neni 64, pika 5, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “ *Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës* ”.
11. Trupi gjykues, çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi, është bërë i pamundur, referuar nenit 95, “*Pamundësia në objekt apo qëllim*”, të Kodit Procedurës Administrative, i cili specifikon se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.
12. Në pikën 6, të nenit 4, të ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe germa “c”, pika 1, e nenit 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Apostol Prifti, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet, z. Apostol Prifti, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 08.05.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Suela ZHEGU
Relatore

Etmonda Hoxha
Sekretare gjyqësore